



ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS  
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA  
KOSOVA BAR ASSOCIATION

Në bazë të nenit 40 lidhur me nenin 41 par. 3 pika 3.4 dhe nenin 42 par. 2 të Ligjit për Avokatinë Nr. 04/L-193 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/31 maj 2013), Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 20 dhjetor 2014, aprovon këtë,

## ANEKS STATUT

### Neni 1

Përveç kushteve të përcaktuara me nenin 40 par 5 të Ligjit për Avokatinë kushtet, mënyra dhe procedura sipas të cilëve avokatët nga shtetet e tjera mund të ushtrojnë profesionin e avokatisë në territorin e Republikës së Kosovës përcaktohen me Aneks Statut dhe Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të huaj.

### Neni 2

Shtetasit e huaj kandidatet për ushtrimin e avokatisë në Kosovë, duhet të nënshtrohen provimit të përshtatshmërisë në organizuar nga OAK, në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.

Forma, përmbajtja dhe procedurat tjera të provimit të përshtatshmërisë përcaktohen në Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të huaj.

### Neni 3

Kandidatet për ushtrimin e avokatisë nga shtetasit e huaj duhet të lidhin marrëveshje të bashkëpunimit me avokatin vendore ku avokati vendore në çdo rast duhet të jetë avokati i parë në procedurën gjyqësore ku parashtrohet rasti për të cilin merret licenca.

### Neni 4

Ky Aneks Statut hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Kuvendi Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2015.

**Av. Ibrahim Z. Dobruna**  
Kryetari i OAK-së